



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: "EMSALE" SH.P.K
Numri Unik Identifikues: 810854663
Pronar: Emanuel Dema
OSHMA: Radio RINIA
Adresa: Bulevardi Pavarësia P.13 Kt.6/20, Gjilan



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio - Radio Rinia, me seli në Gjilan

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Rinia është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Gjilan. KPM, me vendimin e datës 06 tetor 2016, lëshimin e licencës së Radio Rinia për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 06 tetor 2023, skadon afati i licencës së Radio Rinia.
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon licenca në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Rinia, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komisioni i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 03 maj 2023, Radio Rinia ka dorëzuar kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës.


Arsyetim

5. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kriterëve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.*
6. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Rinia lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës, ndërsa përmes e-mail-i e ka njoftuar lidhur me dokumentacionin shtesë të nevojshëm.

7. Komisioni konstaton se, Radio Rinia përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar.
8. Komisioni konstaton se Radio Rinia ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
9. Komisioni konstaton se sipas verifikimit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), përmes të dhënave mbi bizneset që mund të shihen në faqen e internetit të kësaj agjencie, nuk ka ndryshim të pronësisë së Radio Rinia dhe figuron emri i pronarit sipas licencës z. Emanuel Dema. Gjithashtu, certifikata përmban edhe kodin e veprimtarisë për transmetimin e programeve të radios.
10. Komisioni e KPM-së konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, Radio Rinia të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
11. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Rinia është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Rinia plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën transmeton kjo radio.

Vendim

12. Komisioni merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës për Radio Rinia, në mënyrë që të vazhdoj me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audio, e cila veprimtari është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar dhe në të cilin është duke transmetuar program Radio Rinia.
13. Licenca e Radio Rinia do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 06 tetor 2023.
14. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Rinia, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.
15. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



10.11.2023
Datë